29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jete kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jete të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm,

periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Paga e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;

- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Implantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse çikado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përipien të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <i>[Shqipe]</i> .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10 % e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 150 ditësh</i> Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 150 ditë</i> . Kontraktuesi do të paguaj shumë prej 17787.61€ , me rastin e nënshkrimit të kontratës , nëse nuk ka vërejtje gjat kësaj kohe në punët e kryera, kontraktuesit do t'i kthehet sigurimi i ekzekutimit, në të kundërtën nëse kontraktuesi dështon në përfundimin e punëve apo nëse paraqiten vërejtje gjat kohës së sigurimit, sigurimi i ekzekutimit do të konfiskohet apo në se ka mundësi të eliminimit të të metave këto mjete do të përdoren për këtë qëllim
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: (ii) të personave të tjerë:
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është [3] ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <i>pas nënshkrimit të kontratës</i>
	17.2	plani dinamik për përfundimin e të gjitha punëve nuk mund të jetë me shumë se 84 ditë punë.maksimumi deri më 30gusht 2018
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë [0.2 % e

		<i>vlerës se kontratë</i> për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	[<i>Specifikoni nëse një regjistër i punës nuk është nevojitet</i>].
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është [<i>shëno numrin, adresën e Menaxherit të Projektit</i>].
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: [<i>shëno shumën</i>].
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: [<i>10 % e vlerës se kontratës 12 muaj pas pranimit teknik e cila mund të jete ne forme te sigurimit bankar apo kompani e licencuar e sigurimit</i>].
Shkaqet kompensim për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 12 muaj kontraktuesi me rastin e pagesës së fundit pas pranimit teknik do të dorzojë sigurimin bankarë të punëve të kryera prej 10% vlerës së kontratës për 12 muaj.
Pagesa	35	Pagesat do të bëhen: sipas situacioneve të përfunduara ne teren dhe të pranuar nga menaxheri i kontratës duke mbajtur 10% nga secila faturë deri sa të arrin shuma 90% e mjeteve të paguara. Pjesa e mbetur për pagesë prej 10% do t'i paguhet kontraktuesit pas pranimit teknik të punëve
Rishikimi çmimeve	i 35.1	<nuk pranohen ndryshime të çmimit , dhe do të paguhet vetëm shuma e cekur në nenin 2 pjesa e parë, në rast se paraqiten pengesa të cilat duhet eliminuar patjeter për realizimin e projektit , do të rregullohet me aneks kontratë
Shkëputja kontratës	e 37	Kontrata mund të shkëputet me vullnetin e njërës palë kontraktuese për shkak të shkeljeve materiale të kontratës, në rastet si në vijim: Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit të punëdhënësit; Menaxheri i projektit urdhëron pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; Pala tjetër kontraktuese falimenton apo hyn në likuidim, përveç me përjashtim të rastit të riorganizimit apo shkrirjes; Menaxheri i projektit në njoftimin me shkrim që i bënë punëmarrësit mbi evitimin e defekteve, e njofton edhe mbi atë se mos evitimi i defekteve paraqet shkelje bazë të kontratës, megjithatë punëmarrësi nuk ndërmerr masat e nevojshme paraprake për evitimin e defekteve, kështu që dështon në korrigjimin e defekteve brenda 30 ditë pune që përcaktohet nga menaxheri i projektit të Punëdhënësit; Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e defekteve

		<p>mund të paguhet;</p> <p>Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje materiale të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me klauzolën 10.1, Menaxheri Projektues do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkelje të kontratës.</p> <p>Kur punëdhënësi i paraqet shkresë përkatësisht vendim mbi shkeljen e kontratës, me këtë kontraktuesi obligohet që brenda 15 ditë pune duke llogaritur nga data e marrjes së vendimit mbi shkeljen e kontratës, ta pastrojë vend ndërtimin nga mbeturinat eventuale që janë paraqitur gjatë kryerjes së punës, ta sigurojë vend ndërtimin dhe të largohet.</p>
Pagesa pas shkeljes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <u>20%</u>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Komisioni përbrenda Komunës, ose deri në instanca më të larta që do të përbëhet nga drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, drejtori i prokurimit dhe drejtori i Planifikimit dhe urbanizëm dhe përfaqësuesi i operatorit ekonomik</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <u>Gjykata Themelore në Lipjan në pajtim me ligjin në Kosovë,</u>

OBJEKTI: SHFMU "DRITA" ETAZHITETI: P+1 LOKACIONI: RUBOFC-LIPJAN

Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin dhe montimin, lidhjet sjelljen e pozicionit ne gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve te prodhuesve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i terë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuar janë të Parallogaritura. Punëkryesi duhet tia prezantoj përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim.

A. PUNËT ARKITEKTONIKE

A.1	PUNËT HIDRO DHE TERMOIZOLUESE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI	TOTALI
A.1.1	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit horizontal me saldim të lidhjeve në nivelin e pllakes se dyshemes, hidroizolimi punohet me material hidroizolues shumështrësor - tipi kondor, t=3mm dhe me nje shtrese lyerje bituliti. Llogaria ne m2	m2	660.00	1.50	990.00 €
A.1.2	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit horizontal në dysheme dhe vertikal në lartësi h=30cm me saldim të lidhjeve në muret e kthinave sanitare ne perdhes dhe kat me material hidroizolues shumështrësor - tipi kondor, me DY SHTRESA t=2x3mm dhe në mes të shtresave lyerje me bitulit.	m2	160.00	2.00	320.00 €
A.1.3	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit te ftohte ne dy shtresa ne dyshemen e nyjeve sanitare mbi nivelizim	m2	80.00	1.00	80.00 €
A.1.4	Furnizimi dhe shtrirja e letres difuzive mbi siperfaqen paraprakisht të mveshur me dërrasa të konstruksionit te kulmit, perfshire te gjitha punet pergatitore . Llogaria në m2 ne projektionin horizontal te kulmit	m2	630.00	0.10 €	63.00 €
			GJITHSEJT..... A.9:		1,453.00
A.2	PUNËT AGJUSTATORE DHE TË ZDRUKTHËTARISË	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI	TOTALI
	Funizimi, punimi dhe montimi i dritareve prej materialit të plastikës sipas standardeve ISO, DIN. Trashesia t=8 cm ne hapje sipas projektit (detaleve te dritareve) me qelq termopan dhe mekanizma te kualitetit te larte. Nga Prodhuesit Trokal, Rehau, Internova etj.				
A.2.1	dimensione 150x140 cm	copë	4.00	155.00	620.00 €
A.2.2	dimensione 325x210 cm	copë	23.00	480.00	11,040.00 €
A.2.3	dimensione 80x80 cm	copë	16.00	75.00	1,200.00 €
A.2.4	dimensione 220x210 cm	copë	6.00	325.00	1,950.00 €
A.2.5	dimensione 130x40 cm	copë	5.00	70.00	350.00 €
A.2.6	Furnizimi me material dhe punimi i siperfaqes ndriqese (fasades gjysem strukturale) me profila te aluminit dhe xham termopan, hapjet sipas skemave. Alumini te jete termik (me nderprerje te ures termike), nga prodhuesi Alumil apo te ngjajshem.	m2	10.00	125.00	1,250.00 €
A.2.7	Furnizimi me material dhe punimi i siperfaqes ndriqese (fasades gjysem strukturale) me profila te aluminit dhe xham termopan, hapjet sipas skemave. Alumini te jete termik (me nderprerje te ures termike), nga prodhuesi Alumil apo te ngjajshem.	m2	16.00	125.00	2,000.00 €

	Furnizimi dhe montimi i dyerve hyrëse prej profileve të aluminit në niançe sipas perzgjedhjes së investitorit dhe qelqim sipas skemës. Prodhuesi Alumil, me profile me ndërprerje të ures termike. Siperfaqja mbulohet me panele termoizoluese nga alumini nga i njëjti prodhues.				- €
A.2.8	dimensione 325x314 cm (dera hyrëse)	copë	1.00	850.00	850.00 €
A.2.9	dimensione 325x332 cm (dyer emergjente)	copë	2.00	920.00	1,840.00 €
A.2.10	dimensione 90x210 (rreshqitese)	copë	1.00	250.00	250.00 €
A.2.11	dimensione 90x210 (me ajrosje)	copë	1.00	250.00	250.00 €
	Furnizimi dhe montimi i derës së erë mbrojtësit (fluturuese) prej profileve të plastikës me trashë të profileve 8 cm në niançe sipas perzgjedhjes së investitorit dhe qelqim sipas skemës				- €
A.2.12	dimesione 315x314	copë	1.00	750.00	750.00 €
A.2.13	dimensione 150x265	copë	1.00	650.00	650.00 €
	Furnizimi dhe montimi i dyerve të Nyjeve Sanitare nga materiali i plastikës sipas ISO, DIN standardeve. Nga Prodhuesit Trokal, Rehau, Internova etj.				- €
A.2.14	dimensione 80x210 cm	copë	9.00	135.00	1,215.00 €
A.2.15	dimensione 100x210 cm	copë	1.00	140.00	140.00 €
A.2.16	dimensione 70x180 cm	copë	14.00	125.00	1,750.00 €
A.2.17	dimensione 70x210 cm	copë	4.00	130.00	520.00 €
	Furnizimi dhe montimi i dyerve të klaseve dhe kthinave tjera nga furniri. Dyert duhet të jenë të klasit të parë, dhe me të gjitha elementet tjera perxjellëse. Dru i plote me trashësi të krahut 4cm.				- €
A.2.18	dimesione 100x210 cm	copë	13.00	145.00	1,885.00 €
A.2.19	dimesione 90x210 cm	copë	3.00	135.00	405.00 €
				GJITHSEJT..... A.10:	28,915.00
A.3	PUNËT SUVATUESE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI	TOTALI
A.3.1	Pastrimi dhe sperkatja me qumështë qimentoje e mureve të brendshme dhe pllafoneve para fillimit të suvatimit. Llogaria në m ²	m ²	3,200	0.55	1,760.00 €
A.3.2	Suvatimi i mureve të brendshme me llaq gelqeror në përpjesë 1:3 në dy shtresa me finalizim të lëmuar. Në pozicion të parashihet vendosja e kendoreve në të gjitha këndet	m ²	2,100	3.50	7,350.00 €
A.3.3	Suvatimi i pllafoneve me llaq gelqeror në përpjesë 1:3 në dy duar me finalizim të lëmuar. Në pozicion të parashihet vendosja e kendoreve në të gjitha këndet.	m ²	1,050	3.50	3,675.00 €
A.3.4	Suvatimi i shkalleve të perdhesës me llaq gelqeror në përpjesë 1:3 në dy duar me finalizim të lëmuar. Në qmim të merret edhe sperkatja me qumështë qimentoje	m ²			
			30.00	3.50	105.00 €
				GJITHSEJT..... A.11:	12,890.00

A.4	PUNET E GLETIT DHE FSADES	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI	TOTALI
A.4.1	Furnizimi me material dhe gletimi i te gjitha mureve të brendshme ne dy shtresa (ketu nuk parashihen muret te nyjet sanitare), paraprakishte të behet pergaditja me lenden baze, sipërfaqja duhet te jete e lemuar dhe gatshme per ngjyrosje.	m ²	1,700	1.00	1,700.00 €
A.4.2	Furnizimi me material dhe gletimi i pllafoneve ne dy shtresa paraprakishte të behet pergaditja me lenden baze, sipërfaqja duhet te jete e lemuar dhe gatshme per ngjyrosje, ne pozicionin e pllafonit jane marre ne sipërfaqe katror trajet e leshuara	m ²	965.00	1.00	965.00 €
A.4.3	Furnizimi me material dhe punimi i fasades se jashtme nga tullat e fasades dizajni dhe forma sipas organit mbikqyres, ne qmim te kalkulohet inkastrimet e nevojshme, trau i poshtem dhe shtangimet tjera nga beton armeja, punimi i shtreses termoizoluese nga leshi i gurit me dy shtresa 2x5.0 cm te mbeshtjellur me foli te integruar difuzive, llogaria ne m ²	m ²	600.00	26.50	15,900.00 €
A.4.4	Furnizimi me material dhe punimi i fasades se jashtme-atika nga tullat e fasades dizajni dhe forma sipas organit mbikqyres, ne qmim te kalkulohet inkastrimet e nevojshme, shtangimet nga beton armeja, llogaria ne m ²	m ²	120.00	20.00	2,400.00 €
A.4.5	Furnizimi dhe ekzekutimi i kolirit ne cokull dhe pjesen e mureve te ngritura te coklles në niansë sipas përzgjedhjes së organit mbikqyres paraprakishte sipërfaqja duhet te pargaditet dhe lyhet me shtresat e nevojshme, te parashihet edhe vendosja e shtreses termoizoluse nga stiroduri 5cm.	m ²	70.38	4.00	281.52 €

GJITHSEJT..... A.12

21,246.52

A.5	PUNËT E NGJYROSJES	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI	TOTALI
A.5.1	Ngjyrosja e mureve te mbrendeshme dhe pllafoneve mbi bazament të gletuar me polikolor ne dy shtresa me niansë të bardhë	m ²	2,100	0.35	735.00 €
A.5.2	Furnizimi dhe lyerja e mureve te klasave dhe koridoreve me ngjyre te yndyrshme ne lartesi h = 1.5 m.	m ²	500.00	0.75	375.00 €

GJITHSEJT..... A.13

1,110.00

A.6	PUNËT E KERAMIKËS DHE GRANITIT	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI	TOTALI
-----	--------------------------------	--------	-------	-------------	--------

A.6.1	Furnizimi me material dhe mveshja e mureve (sanitaret) me pllaka të keramikës te kualitetit te lartë, me ngjites adekuat, ne qmim te parashihen edhe mbushja e fugave Dizajni sipas organit mbikqyres	m ²	400.00	10.00	4,000.00 €
A.6.2	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshmeve (sanitaret) me pllaka të keramikës te kualitetit te lartë, me ngjites adekuat, ne qmim te parashihen edhe mbushja e fugave Dizajni sipas organit mbikqyres	m ²	80.00	10.00	800.00 €
A.6.3	Furnizimi dhe mveshja e dyshemesë se koridorit, hollit hyres, hapsirave per shume qellime erembrojteseve dhe hapsirave tjera me pllaka te granitit artificial 60x60 cm me ngjites adekuat, ne qmim te parashihen edhe mbushja e fugave dizajni sipas investitorit.	m ²	290.00	12.50	3,625.00 €
A.6.4	Furnizimi dhe vendosja e keramikës ose granitit artificial rreth perimetrit te mureve ne lartesi t=10.0 cm	m1	210.00	5.00	1,050.00 €
A.6.5	Furnizimi dhe mveshja e shkalleve kryesore te perdheses me pllaka të granitit natyror. Pllakat e shkeleseve t=3 cm ndersa te balloreve t=2 cm. Llogaria ne m2 te siperfaqes mvesheshese te shkalles	m2	36.50	30.00	1,095.00 €
A.6.6	Furnizimi dhe mveshja e shkalleve dhe platove te jashtme me pllaka teraco me trashesi t=2.0 cm . Dizajni sipas perzgjedhjes se Investitorit	m2	198.20	10.00	1,982.00 €
A.6.7	Furnizimi dhe mveshja e sallobankave te dritaret ne anen e mbrendeshme nga mermeri me trashesi t=2.0 cm, me b=20 cm te ngjiture me ngjites adekuat llogaria ne m1	m'	164.0	5.00 €	820.00 €
GJITHSEJT..... A.14:					€ 13,372.00

A.7	PUNËT E LINOLEUMIT	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI	TOTALI
A.7.1	Furnizimi dhe vendosja e dyshemesë se linoleumit (ne rolne) liidhja behert me ngjites adekuat, ne llogari te merret shtresa vetë nivilizuese, ngjitesi adekuat, diktuni dhe shiriti rreth perimetrit te mureve ne lartesi h=8 cm.	m ²	645.00	7.00	4,515.00 €
GJITHSEJT..... A.15:					4,515.00

A.8	NDERTIMI I FUSHES	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI	TOTALI
A.8.1	Gërmimi I humusit në thellësi prej mes. 45 cm, germimi duhet te behet ne tere siperfaqen e fushes se futbollit, si dhe transporti I dheut deri ne deponi.	m3	462.80	1.00	462.80 €

A.8.2	Rrafshimi dhe nivelizimi i nënbazës së sipërfaqes së fushës me saktësi deri në ± 2 cm, duke krijuar pjerresin e nevojshme terthore për kullimin e ujrave sipërfaqesore, ngjeshja me cilindër vibrues deri në arritjen e kompaktës prej $M_s = 30$ Mpa.	m ²	650.00	0.10	65.00 €
A.8.3	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e materialit nga guri I thyer me frakison 0-63 mm me trashësi $t = 20$ cm në gjendje të ngjeshur ($M_s = 50$ Mpa).	m ³	185.00	7.00	1,295.00 €
A.8.4	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e materialit nga guri I thyer me frakison 0-31.5 mm me trashësi $t = 10$ cm në gjendje të ngjeshur ($M_s = 70$ Mpa).	m ³	94.00	8.00	752.00 €
A.8.5	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e asfaltit betonit AB 16 mm me trashësi $t = 7$ cm në gjendje të ngjeshur, sipërfaqes duhet të ipet ramja për largimin e ujrave atmosferike. Llogaritur në meter katrorë.	m ²	660.00	8.50	5,610.00 €
A.8.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e skajoreve me dimensione 8/20 cm për kufizimin e fushës, në qmim të llogaritët betoni për shtangimin e skajoreve	m'	103.00	4.50	463.50 €
A.8.7	Trajtimi dhe rregullimi i sipërfaqes për rreth fushës dhe gjelberimit	m'	103.00	1.00	103.00 €
A.8.8	Të bëhet furnizimi dhe punimi i vijave të fushës me ngjyrë të akrilike kualiteti të lartë e qëndrueshme ndaj ndikimeve atmosferike me nuancë të bardhë sipas projektit, llogaritur komplet	komplet	1.00	250.00	250.00 €
A.8.9	Të bëhet furnizimi dhe punimi i vijave të fushave ndihmëse të basketit me ngjyrë të akrilike kualiteti të lartë e qëndrueshme ndaj ndikimeve atmosferike me nuancë të verdhë sipas projektit, llogaritur komplet	komplet	1.00	200.00 €	200.00 €
A.8.10	Të bëhet furnizimi, transporti dhe vendosja e gollave në fushë me dimensione 3x2 m të parashihet edhe rrjeta adekuate sipas detalit në projekt..	copë	2.00	150.00	300.00 €
A.8.11	Të bëhet furnizimi, transporti dhe fiksimi i koshave për basketboll. Në qmim të kalkulohet hapja e gropës, betonimi, konstruksionit metalik, tabela koshi dhe të gjithë aksesoret tjerë për xjellës	copë	2.00	550.00	1,100.00 €
GJITHSEJTI.....A.16:					10,601.30

A.9	NDERTIMI I PLATOS	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI	TOTALI
A.9.1	Gërmimi i humusit në thellësi prej 30 cm, gërmimi duhet të bëhet në tërësi sipërfaqen e platos, si dhe transporti i dheut deri në deponi.	m ³	367.45	1.00	367.45 €

A.9.2	Rrafshimi dhe nivelizimi i nënbazës së sipërfaqes së fushës me saktësi deri në ± 2 cm, duke krijuar pjerresin e nevojshme terthore për kullimin e ujrave sipërfaqesore, ngjeshja me cilindër vibrues deri në arritjen e kompaktësis prej $M_s = 30$ Mpa.	m ²	900.00	0.10 €	90.00 €
A.9.3	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e materialit nga guri i thyer me frakison 0-63 mm me trashësi $t = 20$ cm në gjendje të ngjeshur ($M_s = 40$ Mpa).	m ³	268.00	15.00	4,020.00 €
A.9.4	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e materialit nga guri i thyer me frakison 0-31.5 mm me trashësi $t = 10$ cm në gjendje të ngjeshur ($M_s = 60$ Mpa).	m ³	134.00	15.00	2,010.00 €
A.9.5	Furnizimi, transporti, vendosja e kubzave me dimensione 20x20x6 cm me ngjyre të hirit dhe të kuqe, në qmim të kalkulohet shtresa e reres fraksin 4 mm me trashësi $t = 5$ cm dhe mbushja e fugave të kubzave me rer të imet. Llogaritur në meter katrorë.	m ²	900.00	7.00	6,300.00 €
A.9.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e skajoreve me dimensione 8/20 cm për kufizimin e platos, në qmim të llogaritet betoni për shtangimin e skajoreve	m'	224.00	3.00	672.00 €
A.9.7	Trajtimi dhe rregullimi i sipërfaqes për rreth trotuarit dhe gjelberimit	m'	224.00	0.50	112.00 €

GJITHSEJT.....A.17: 13,571.45

A.10	PUNËT E RRETHOJËS SE OBORRIT TE SHKOLLES	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI	TOTALI
